



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucion i Avokatit të Popullit  
Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Nr./Br./No. 69012019  
Nr. fqi/Br.str./Nr.pg. 23/04/19  
Data/Datum/Date:



PRISHTINË • PRIŠTINA • PRISTINA  
Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucion i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Prishtinë, më 23 prill 2019

Z. Alush Musaj, Rektor  
Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini”  
Rr. “Ukshin Kovaçica”, p.n.  
40000 Mitrovicë

## LETËR REKOMANDIMI

Ankesa nr. 30/2019

Shpëtim Salihu  
kundër  
Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”

I nderuari z. Musaj,

Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 10 janar 2019, ka pranuar ankesë nga z. Shpëtim Salihu parashtruar kundër Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” (UMIB).

Sipas informatave të pranuara nga ankuesi, kuptohet se, pas përfundimit të konkursit dhe të procedurave tjera lidhur me konkursin në të cilin ankuesi është përzgjedhur si asistent i angazhuar në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike, Senati i UMIB-it, përmes Vendimit nr. Prot. 1564, i datës 5 nëntor 2018, ka vendosur që nënshkrimi i kontratës me z. Salihun të shtyhet deri pas pranimit të opinionit nga Agjencia kundër Korrupsionit (AKK) lidhur me mundësinë e ekzistimit të konfliktit të interesit në rastin konkret.

Më 24 dhjetor 2018, UMIB-i ka pranuar njoftim nga AKK-ja rreth mundësisë së konfliktit të interesit në këtë rast.

Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit, më 25 janar 2019, i ka dërguar shkresë UMIB-it, duke kërkuar informacione për veprimet që i ka ndërmarrë UMIB-i gjatë procedurave të konkursit dhe përzgjedhjes së z. Shpëtim Salihut; për zhvillimet gjatë periudhës kur çështja e ngritur nga UMIB-i ka qenë duke u trajtuar në AKK; si dhe për veprimet që UMIB-i planifikon t'i ndërmarrë me qëllim të zgjidhjes së këtij rasti.

Më 15 shkurt 2019, UMIB-i ka kthyer përgjigje dhe ka njoftuar se për rastin e z. Shpëtim Salihut do të vendoset në njëren nga mbledhjet e Senatit të UMIB-it, duke u bazuar edhe në njoftimin e AKK-së.

Më tej, më 19 mars 2019, ankuesi e ka njoftuar përfaqësuesin e IAP-së se Senati i UMIB-it e ka eliminuar ankuesin nga procedura e rekrutimit, duke u bazuar tërësisht në njoftimin e AKK-së.

Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit tërheq vëmendjen:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton: “*E drejta e punës dhe e ushtrimit të profesionit është e garantuar.*” (neni 49); si dhe: “*Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuara ndërkombëtarisht.*” (neni 3).
- Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi përcakton: “*Diskriminim është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, që ka për qëllim apo efekt të zhvlefësoj ose cenoj njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës.*”

Ndër të tjera, Avokati i Popullit e ka analizuar njoftimin e AKK-së dhe ka vërejtur se, me anë të këtij njoftimi, AKK-ja e ka njoftuar UMIB-in se z. Shpëtim Salihu është në konflikt interesni, për shkak të ndalesës së përcaktuar në Rregulloren e Universitetit nr. prot. 1201, e datës 11 shtator 2018.

Avokati i Popullit konstaton se, sipas njoftimit në fjalë, AKK-ja ka dhënë disa konstatime të cilat nuk duken bindëse. Në këtë drejtim, AKK-ja ka konstatuar: “*Duke e parë ndalesën e Rregullores së Universitetit të Mitrovicës, ndërkohë që sa ishte rasti duke u trajtuar në AKK, qëllimi isht ndryshohet lista e angazhimit për vitin 2018/2019 të datës 27 nëntor 2018, e që z. Avdi Salihu i hiqen angazhimet në Departamentin e Inxhinierisë Ekonomike, kjo është bërë vetëm sa për t’iushmangur ndalesës së përcaktuar në Rregullore.*” Avokati i Popullit konsideron se, në të dyja rastet, AKK-ja vetëm ka konstatuar, por nuk e ka argumentuar fare konstatimin (“qëllimi isht” dhe “vetëm sa përt’iushmangur ndalesës”) e dhënë lidhur me rastin në fjalë, gjë që bën të kuptohet se konstatimet e tillë janë të paqëndrueshme.

Për më tepër, Avokati i Popullit tërheq vëmendjen tek Ligji nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, sipas të cilit përcaktohet: “*Zyrtari duhet të shmang konfliktin e interesit pavarësisht nëse ai është real, i mundshëm apo në dukje.*” (neni 5, paragrafi 8); e po ashtu përcaktohet: “*Në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari sipas rastit dhe rrëthanave. (...) merr masa për vetëpërjashtimin ose përjashtimin paraprak nga procesi i vendimmarrjes, diskutimit dhe votimit të çështjes në konflikt me përjashtim të rasteve të përcaktuar shprehimisht me ligj.*” (neni 19, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2).

Në këtë drejtim, Avokati i Popullit konsideron se konstatimi i AKK-së, në të cilin thuhet se ndryshimi i listës së angazhimit është bërë qëllimi isht dhe vetëm sa përt’iushmangur ndalesës në rregullore, është në kundërshtim me nenin 5, paragrafi 8, si dhe me nenin 19, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, ku rregullohen veprimet që zyrtarët duhet t’i ndërmarrin për shmangien dhe parandalimin e konfliktit të interesit.

Më tej, sipas këtij njoftimi, AKK-ja pretendon se UMIB-i duhet t’i zhvillojë politikat në mbrojtje të interesit të përgjithshëm dhe të shmanget nga politikat të cilat mund të krijojnë nepotizëm në institucion. Me këtë qëndrim të AKK pajtohet në tërësi edhe Avokati i Popullit, sepse kjo ndikon në funksionimin e mirëfilltë të UMIB-it.

Kodi i Etikës i UMIB-it e përcakton nepotizmin si në vijim: “*Nepotizëm është kur një profesor, një studiues, apo një anëtar i personelit teknik apo administrativ, drejtpërdrejt ose tërthorazi (madje, edhe duke përdorur financime të palës së tretë) përdor reputacionin ose aftësinë e tij bindëse për të ofruar favore, për të përshtatur shpalljet dhe kontratat e punës, për të ndikuar në rezultatet e konkurrencës apo procedurat e përgjedhjes, veçanërisht, ato të cilat kanë të bëjnë me fillimin apo vazhdimin e karrierës universitare (kjo i prek edhe bursat, kontratat, kontratat për asistentët hulumtues), si dhe pranimin e fëmijëve, pjesëtarët e familjeve dhe të afërmve (në formë të bashkëjetesës dhe miqësisë).*”

Avokati i Popullit vlerëson se AKK-ja nuk e ka argumentuar se z. Avdi Salihu ka ndikuar në ndonjë mënyrë në drejtim të punësimit të djalit të tij në Universitetin e Mitrovicës dhe fakti që z. Avdi Salihu është mësimdhënës në një departament tjeter nuk duhet të merret si rrethanë për eliminimin e z. Shpëtim Salihut nga përgjedhja si asistent i rregullt dhe me honorar në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike për grup lëndësh në Makineri Prodhuase në programin Inxhinieri Ekonomike.

Lidhur me çështje të tilla, Avokati i Popullit, më 12 shkurt 2018, ka publikuar Raport me Rekomandime nr. 853/2016 në lidhje me kriteret diskriminuese në konkurset për punësim në Universitetin e Prishtinës (UP). Në këtë raport, Avokati i Popullit ka konstatuar se në mënyrë specifike e kuption problemin e nepotizmit, si një formë e veçantë e konfliktit të interesit, që është jashtëzakonisht i shpeshtë me rastin e punësimit në sektorin publik. Megjithatë, shtypja e nepotizmit nuk e nënkupton përjashtimin e plotë të të afërmve, por e nënkupton ndalimin e keqpërdorimit të pozitës së nepunësve civilë për të siguruar punë për anëtarët e familjes. Qëllimi nuk është t'i pengojë anëtarët e familjes të punojnë së bashku, por ta parandalojë mundësinë që një nepunës civil të jetë i njëanshëm, ta favorizojë ose ta shfrytëzojë ndikimin dhe pozitën e tij për anëtarët e familjes në ushtrimin e kompetencave diskrete për të punësuar nepunës civilë të kualifikuar.

Avokati i Popullit konsideron se qëllimi i konkursit publik reflektohet në parimin e qasjes së barabartë të të gjithë qytetarëve që, në kushte të njëjta, të aplikojnë në mënyrë të barabartë për çdo vend pune në sektorin publik. Barazia në punësim është kusht bazë i barazisë para ligjit.

Një person, për shkak të disa prej karakteristikave të tij personale ose, në rastin konkret, raporteve të ngushta familjare, si dhe raporteve të punës që kanë brenda departamentit ose programit të UP-së, nuk mund të privohet nga e drejta për punësim, e cila për të tjerët është e qasshme dhe u njihet në masë të plotë, sepse, me këtë, ky person vihet në pozitë të pafavorshme krahasuar me kandidatët e tjerë dhe të njëjtit nuk i lejohet në kushte të barabarta të konkursit të marrë pjesë në garë gjatë procedurës së rekrutimit, por është e rëndësishme të theksohet se, në raste të tilla, procedura e rekrutimit kërkon transparencë të plotë.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se punësimi dhe avancimi në universitetet publike në Republikën e Kosovës duhet të bëhet për të gjithë në kushte të barabarta, duke e respektuar plotësisht parimin kushtetues të barazisë dhe qasjen e barabartë në shërbimet publike.

Avokati i Popullit konsideron se në konkurse duhen respektuar kriteret e përcaktuara, kualifikimet e kërkua, aftësitë e punës së kandidatit që aplikon për punë.

Në të gjitha rastet e punësimit apo të avancimit, nuk do të duhej të ndodhte trajtimi preferencial për arsyet e lidhjeve familjare ose të ngjashme, ashtu siç nuk do të duhej që, për të njëjtat arsyet, të ketë trajtim më të pafavorshëm apo përjashtues.

Së këndejmi, Avokati i Popullit konstaton se eliminimi i z. Salihut në këtë mënyrë ia cenon atij të drejtën për punë dhe ushtrim të profesionit, e po ashtu e diskriminon atë në procedura të rekrutimit.


Prandaj, Avokati i Popullit i

## REKOMANDON

### Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”

- *Ta rishqyrtojë rastin e z. Shpetim Salihut, duke pasur parasysh të drejtën kushtetuese lidhur me të drejtën e punës dhe të ushtrimit të profesionit dhe të drejtën e barazisë para ligjit, duke iu shmangur çdo forme të diskriminimit, për ç' gjë mund t'i referohet edhe Raportit me Rekomandime nr. 853/2016 të Avokatit të Popullit, në lidhje me kriteret diskriminuese në konkursen për punësim në UP.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Cdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkua e në pajtim me ligj*”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, (...) duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë*”), mirësisht ju lutemi që të na informoni për veprimet që do t'i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.



Me ndërime,  
Hilmi Jashari  
Avokat i Popullit

Bashkëngjitur: Raporti me Rekomandime Ex Off Nr. 853/2016 në lidhje me kriteret diskriminuese në konkursen për punësim në UP.